



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPËLLIT

Ex officio nr. 438/2024

Ndikimi i Inteligjencës Artificiale në të Drejtat Themelore të Njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës

Drejtuar:

Znj. Albulena Haxhiu, kryetare e kuvendit
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Z. Albin Kurti, kryeministër në detyrë
Qeveria e Republikës së Kosovës

Z. Lulëzon Jagxhiu, ministër në detyrë
Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike

Z. Hajrulla Çeku, ministër në detyrë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Znj. Krenare Sogojeva Dërmaku, komisionare
Agjencia për Informim dhe Privatësi

Z. Hysen Muzliukaj, drejtor i përgjithshëm
Instituti i Kosovës për Administratë Publike

Prishtinë, më 10 qershor 2026

Qëllimi i Raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse mbi ndikimin e teknologjive të Inteligjencës Artificiale (në vijim: IA) në të drejtat e njeriut, duke trajtuar rreziqet dhe përfitimet e mundshme.
2. Raporti synon të ofrojë një perspektivë të qartë për rolin e IA-së në të drejtat e njeriut, duke pasqyruar kornizat rregullative ligjore, praktikat dhe rekomandimet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, në raport me trendet aktuale dhe reflektimin e tyre në vendin tonë.
3. Raporti u iniciua sipas detyrës zyrtare (ex officio) dhe paraqet rekomandimet e nevojshme për parandalimin e cenimit të të drejtave të njeriut nga sistemet teknologjike të IA-së, të cilat pritet të zhvillohen dhe të përdoren në të ardhmen si nga sektori publik, ashtu edhe nga ai privat.

Baza ligjore e Avokatit të Popullit

Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- *“Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.”* (neni 16, paragrafi 4).
 - *“Publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë.”* (neni 16, paragrafi 15).
 - *“Të rekomandoj qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.”* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5).
- “Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.”* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5).

Përmbledhja e fakteve dhe veprimet e Avokatit të Popullit

4. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 13 maj 2024, filloi hetime me vetiniciativë (ex officio) lidhur me ndikimin e IA-së në të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
5. Duke marrë parasysh dinamikën e zhvillimeve të IA-së në nivel ndërkombëtar dhe sfidat për parandalimin e ndikimit të saj negativ në të drejtat e njeriut, Avokati i Popullit, duke u bazuar në mandatin e tij kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave, vlerësoi me rëndësi të veçantë ndërmarrjen e një iniciative për zhvillimin e një hulumtimi në nivel ndërkombëtar dhe vendor. Ky hulumtim ka për qëllim identifikimin e rreziqeve që IA-ja mund të paraqesë në zbatimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në vend, si dhe përcaktimin e veprimeve rregullative të nevojshme që shteti duhet të

ndërmarrë për t'i parandaluar ato, duke u mbështetur në praktikat e deritanishme ndërkombëtare.

6. Më 17 gusht 2024, Avokati i Popullit, duke u bazuar në fushëveprimin e Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Kosovës, e cila, ndër të tjera, zbaton politikat publike dhe legjislacionin në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ekonomisë digjitale, iu drejtua me shkresë ministres së Ekonomisë, përmes së cilës kërkoi të informohet për veprimet që u ndërmorën ose që planifikohen të ndërmerren në lidhje me përdorimin e IA-së në vend, për çështjet e renditura më poshtë: (i) nëse ka filluar përdorimi i IA-së në institucionet publike të Republikës së Kosovës dhe, nëse po, në cilat fusha janë duke u shfrytëzuar mjetet e IA-së; (ii) nëse kanë filluar të ndërmerren veprime për rregullimin ligjor për mënyrën e përdorimit të IA-së në vend; (iii) nëse është filluar me adoptimin e akteve ndërkombëtare në legjislacionin vendor lidhur me përdorimin e IA-së; (iv) cilat autoritete/mekanizma ligjorë janë kompetentë për mbikëqyrjen e teknologjisë digjitale në dimensionin e IA-së; (v) nëse janë paraparë programe trajnimi për punonjësit e institucioneve publike mbi mjetet dhe teknologjitë e IA-së; dhe (vi) nëse janë paraparë apo janë planifikuar masa në lidhje me parandalimin e ndikimit negativ të Inteligjencës Artificiale në të drejtat e njeriut të garantuara me rendin juridik të Republikës së Kosovës.
7. Më 26 shtator 2024, meqenëse nuk mori përgjigje brenda afatit të përcaktuar, Avokati i Popullit iu drejtua ministres së Ekonomisë me shkresë rikujtuese.
8. Më 13 tetor 2024, Avokati i Popullit mori përgjigje nga Ministria e Ekonomisë, nëpërmjet së cilës kjo e fundi ofroi informatat si vijon:

“Transformimi digjital është proces thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Në këtë drejtim, teknologjitë më të rëndësishme të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve nga pikëpamja globale janë: (a) Inteligjenca Artificiale, (b) Interneti i Gjërave (IoT), (c) Teknologjia 5G, (d) Edge dhe Cloud computing, (e) Big Data, dhe (f) Teknologjia Blockchain.

Adoptimi në rritje i inteligjencës artificiale (AI) po riformëson ekonominë, shoqërinë dhe shtetet në përgjithësi. Shfrytëzimi i teknologjive të reja medoemos implikon qasjen në inteligjencë artificiale, andaj qasja në këto teknologji duhet të jetë me përgjegjësi dhe vëmendje duke u siguruar që shfrytëzimi i tyre të jetë mbi bazën etike dhe në mënyrë transparente.

AI ka një potencial të jashtëzakonshëm për të përmirësuar mirëqenien sociale dhe ekonomike. Zhvillimi dhe vendosja e AI po përshpejtohet. Për vendin tonë, përfitimet e adoptimit të AI përfshijnë operacione më efikase dhe të sakta të agjencive, analiza më të mira të të dhënave dhe vendime të bazuara në prova, dhe ofrim të përmirësuar të shërbimeve për qytetarët.

Për të arritur përdorimin inovativ të AI, vendet kanë nevojë për një sistem rregullator modern dhe efektiv. Në nivel ndërkombëtar, qeveritë kanë prezantuar rregullore të reja për të adresuar rreziqet e veçanta të AI, të fokusuara në masat mbrojtëse parandalues, të bazuar në rrezik, që zbatohen në të gjithë zinxhirin e furnizimit dhe gjatë gjithë ciklit jetësor të AI.

Bazuar në Rregulloren Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ('Rregullore'), Ministria e Ekonomisë ka përgjegjësi të zhvilloj dhe përkrah sektorin e TIK-ut, në veçanti tregtinë elektronike, identifikimin elektronik, sigurinë e sistemeve të informacionit në fushat që mbulon ministria. Inteligjencën Artificiale, si dhe teknologjitë tjera të reja (Internet of Things, Big Data, Cloud Computing, Virtual Reality, 3D Printing etj.);

Në përputhje me përgjegjësitë institucionale, Ministria e Ekonomisë në dokumentin strategjik 'Agjenda Digjitale e Kosovës 2030'. Në kuadër të këtij dokumenti Strategjik ndër të tjera është planifikuar aktiviteti: Zhvillimi i një kursi semestral në universitet që mëson bazat e Inteligjencës Artificiale (IA). Gjithashtu, sipas planit të veprimit është paraparë hartimi i Strategjisë së Kosovës për Inteligjencë Artificiale në ndërlidhje me Strategjinë e Kosovës për të Dhëna (Develop Kosovo AI Strategy 2030 in connection to Kosovo Data Strategy).

Kosova është në fazat fillestare të integritit të plotë të akteve ndërkombëtare në legjislacionin vendor lidhur me AI. Në lidhje me këtë, parakusht është hartimi i legjislacionit të ri, përshtatja e ligjeve ekzistuese, si dhe pjesëmarrjes aktive në forume ndërkombëtare që adresojnë sfidat dhe mundësitë që paraqet AI. Bazuar në aktivitetet e planifikuara në lidhje me AI të Agjendës Digjitale 2023, Kosova do të krijojë mjedisin e duhur për promovimin dhe përvetësimin e teknologjive inovative (p.sh. AI, Interneti i Gjërave, Blockchain) dhe për krijimin e ambientit të favorshëm për investime private, e veçanërisht komponentën e Hulumtimit dhe Zhvillimit.

Aktiviteti: "Zhvillimi i kornizës ligjore, rregullave dhe normave për një ekosistem inteligjent/ novator", ka për qëllim të përcaktoj kuadrin ligjor dhe të zhvillojë rregulla dhe norma për një ekosistem inteligjent/ inovator i cili do të jetë në përputhje me rregulloret tashmë ekzistuese evropiane (p.sh. rregullat e harmonizuara të BE-së për IA - Akti i Inteligjencës Artificiale 2021, Ligji i Përgjithshëm Rregullorja për Mbrojtjen e të Dhënave (Rregullorja (BE) 2016/679), dhe do të nxisë promovimin e Teknologjive Inovative për t'u bërë motori i ri i rritjes ekonomike dhe forcimit të konkurrencës.

Teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit përfshirë këtu AI po zhvillohen e ndryshojnë shumë shpejtë si në formë, ashtu dhe në përmbajtje, andaj Ministria jonë po bën përpjekje të përcjell zhvillimet ndërkombëtare në këtë fushë dhe të veproj konform masave të ndërmarra nga vendet tjera.

Për më tepër, Ministria e Ekonomisë tani është në fazën e tenderimit të projektit "Implementimi i Rrjetit të pavarur jopublik 5G në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren". Me zbatimin e këtij projekti që planifikohet të përfundoj gjatë vitit 2025, do të zhvillohen dhe krijohen mundësi testimi për aplikimin e teknologjive të reja të avancuara si Inteligjenca Artificiale, Machine Learning e shërbime tjera digjitale.

Sipas Rregullores, Ministria e Ekonomisë përmes Departamentit të Teknologjisë Informative dhe Komunikuese, ka përgjegjësi për zhvillimin dhe zbatimin e politikave për inovacion dhe transformim digjital, përfshirë AI. Megjithatë, ky proces kompleks kërkon qasje gjithëpërfshirëse, përfshirë këtu Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (Ministria e Punëve të Brendshme), Agjencia për Informim dhe Privatësi, si dhe institucionet e tjera përgjegjëse në nivelin ekzekutiv por edhe atë legjislativ.

Në lidhje me programet e trajnimit, ju informojmë që në përputhje me Ligjin Nr. 04/L - 221 Për Institutin e Kosovës për Administratë Publike, Instituti i Kosovës për Administratë Publike ('IKAP') është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, aftësimit profesional dhe zhvillimit të kapaciteteve në shërbimin civil, duke përfshi të gjitha institucionet e shërbimit civil të nivelit qendror dhe lokal. IKAP përveç funksioneve të tjera, ka përgjegjësinë të identifikoj dhe vlerësoj, në mënyrë periodike, nevojat për aftësimin e nëpunësve civil të Kosovës në nivelin qendror dhe lokal.

Si përfundim, legjisllacioni dhe politikat strategjike në lidhje me AI, janë shtylla kryesore për vendosjen e dispozitave normative dhe kështu sanksionimin e veprimeve për të minimizuar ndikimet e mundshme negative në shoqëri nga përdorimi i teknologjive që mundësojnë shfrytëzimin e inteligjencës artificiale.”

9. Më 27 gusht 2025, përfaqësuesja e Institucionit të Avokatit të Popullit (në vijim: IAP), përmes adresës elektronike, iu drejtua drejtorit të Departamentit të Teknologjisë Informative dhe Komunikuese në Ministrinë e Ekonomisë, me kërkesë për informata të reja, respektivisht për të mësuar nëse nga data e përgjigjes së lartshënuar e deri më tani kjo Ministri ndërmori veprime të reja, apo nëse ka informata lidhur me progresin e zbatimit të aktiviteteve që janë në procedurë.
10. Më 22 shtator 2025, përfaqësuesja e IAP-së nëpërmjet adresës elektronike iu drejtua drejtorit të Departamentit të Teknologjisë Informative dhe Komunikuese në Ministrinë e Ekonomisë, me shkresë rikujtuese, por nuk mori përgjigje.

Baza ligjore

Dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të zbatueshme për rastin konkret

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 7 [Vlerat]

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, të paqes, të demokracisë, të barazisë, të respektimit të të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe të sundimit të ligjit, të mosdiskriminimit, të së drejtës së pronës, të mbrojtjes së mjedisit [...].”

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. [...].”

Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa

Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese; (9) Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.”

Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Neni 1

“Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi.”

Neni 2

“Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër.

Asnjë dallim nuk do të bëhet në bazë të statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose vendit të cilit i përket çdo njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetëqeverisës ose që gjindet në çfarëdo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit.”

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

Neni 1 [Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut]

“Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Titullin I të kësaj Konvente.”

Koncepti i Inteligjencës Artificiale

11. Inteligjenca Artificiale (në vijim: IA) u referohet sistemeve që shfaqin sjellje inteligjente duke analizuar mjedisin dhe duke ndërmarrë veprime me një shkallë të caktuar të autonomisë për të arritur qëllime specifike.¹ Sistem i IA-së nënkupton një sistem të bazuar në makinë, që është projektuar të funksionojë me nivele të ndryshme të autonomisë dhe që mund të shfaqë aftësi përshtatëse pas vendosjes në përdorim dhe që për qëllime të shprehura ose të nënkuptuara nxjerr nga të dhënat hyrëse që merr, mënyrën se si të gjenerojë të dhëna dalëse, si: parashikime, përmbajtje, rekomandime ose vendime që mund të ndikojnë në mjediset fizike ose virtuale. Zakonisht sistemet e IA-së janë të integruara si pjesë përbërëse të sistemeve më të mëdha dhe jo si sisteme të pavarura.² Pra IA-ja është një fushë e teknologjisë që synon të krijojë sisteme kompjuterike të afta të

¹ European Commission, A definition of AI: Main capabilities and scientific disciplines, 2019, file:///C:/Users/NB/Desktop/Raporti%20IA/ai_hleg_ai_definition_final_DF06F793-EA01-3573-16D2ACD625E2BDB0_56341.pdf

² <https://artificialintelligenceact.eu/article/3/>

kryejnë detyra që zakonisht kërkojnë inteligjencë njerëzore. Këto përfshijnë shumë fusha të veprimtarisë dhe jetës njerëzore.

12. Disa koncepte kyçe që ndihmojnë në kuptimin se si funksionon IA-ja

- i. Mësimi Makinerik (Machine Learning): Në qendër të kësaj teknologjie është trajnimi i makinës apo kompjuterit. Trajnimi bëhet duke e ushqyer sistemin me të dhëna, prej të cilave sistemi zbulon relacionet interne mes të dhënave. Sasia e të dhënave dhe kualiteti i tyre janë esenciale që sistemi të jetë efikas. Për shembull, një model i Mësimi Maninerik mund të trajnohet për të njohur fytyrat në fotografi duke ekspozuar me qindra-mijëra imazhe të fytyrave të ndryshme.
- ii. Rrjetet Neuronale (Neural Networks): Në kontekstin e IA-së, rrjetet neuronale janë konstrukte matematikore të krijuara për të simuluar disa aspekte të të mësuarit njerëzor dhe frymëzohen dhe imitojnë trurin njerëzor. Ato përbëhen nga qeliza të quajtura neurone artificiale (apo perceptrone), të cilat lidhen ndërmjet vete në një rrjet. Funksionimi i tyre bazohet në funksione matematikore që imitojnë funksionin e neuronit biologjik. Rrjetat mund të jenë shumë shtresore dhe në këtë rast flitet për mësim të thellë (deep learning). Informacioni kalon nëpërmjet këtyre lidhjeve dhe përpunohet në çdo shtresë të rrjetit. Gjatë procesit të mësimi, informata kalohet shumë herë nëpër rrjet dhe parametrat e lidhjes ndërmjet shtresave rikalkulohen. Fuqia e rrjeteve neuronale qëndron në aftësinë e tyre për të krijuar modele dhe marrëdhënie komplekse në të dhëna përmes një kombinimi të funksioneve matematikore, teknikave të optimizimit dhe hardverit të specializuar. Këto modele janë veçanërisht të dobishme për detyra të tilla si njohja e imazheve dhe të folurit natyral.
- iii. Procesimi i Gjuhës Natyrore (Natural Language Processing): Ky procesim është fusha e Inteligjencës Artificiale që merret me marrëdhëniet midis kompjuterëve dhe gjuhës njerëzore. Qëllimi është që kompjuterët të kuptojnë dhe të përpunojnë gjuhën njerëzore në mënyrë që të mund të kryejnë detyra, si: përgjigjet automatike, përkthimi i gjuhëve dhe më shumë. Shembuj konkretë janë Modelet e Mëdha Gjuhësore (Large Language Models) shumë të popullarizuara, si: ChatGPT i OpenAI dhe Gemini i Google.
- iv. Sistemet Eksperte: Këto janë sisteme të specializuara të IA-së, që përpiqen të imitojnë vendimmarrjen e një eksperti njerëzor në një fushë të caktuar. Ato janë programuar me rregulla që u lejojnë të vlerësojnë informacionin dhe të marrin vendime bazuar në ato rregulla.
- v. Robotika: Përdorimi i IA-së në robotë për të kryer detyra të ndryshme, si: navigimi, kapja e objekteve, madje edhe ndërveprimi me njerëzit. Robotika ndërlidh IA-në me inxhinierinë mekanike dhe elektrike për të krijuar makina që mund të operojnë në mjedise të ndryshme me efikasitet të lartë, apo duke zëvendësuar gjithashtu punën njerëzore në ambiente të rrezikshme.

13. Në praktikë, IA-ja u integrua në shumë aspekte të jetës së përditshme. Aplikacionet e saj përmirësojnë efikasitetin, personalizimin dhe kapacitetin e teknologjive të ndryshme duke sjellë përfitime, por edhe sfida. Të dhënat e saj ndërlidhen ngushtë dhe janë thelbësore për shumicën e aplikacioneve moderne të IA-së.

14. Vërehet se idetë për ndërtimin e sistemeve të IA-së nuk janë të reja, por janë paraqitur paralelisht me zhvillimin e sistemeve të teknologjisë informative. Idetë e hershme për

këtë inteligjencë kanë qenë të bazuara në konceptin e programimit në bazë të rregullave (“rule-based programming”) që ndjekin programim me rregulla të qarta përmes algoritmeve. Si rezultat u krijuan disa “sisteme eksperte” që nuk patën attribute të IA-së dhe funksionuan vetëm në bazë të rregullave të programuara.

15. Inteligjenca Artificiale sot u ndërtua mbi një paradigëm të re të trajnimit të kompjuterëve prej të dhënave. Sistemet kompjuterike “ushqehen” me të dhëna të përgatitura më parë dhe përmes tyre zhvillojnë aftësinë për të vepruar me të dhëna të reja. Zhvillimi i IA-së mori hov kur u krijuan kushtet e nevojshme teknike dhe teknologjike, kompjuterë dhe sisteme me fuqi të mëdha llogaritëse, të përshtatshme për punë, me sasi të mëdha të dhënash. Faktor shumë i rëndësishëm është digjitalizimi i përgjithshëm i veprimtarisë njerëzore, i cili krijoi sasi të mëdha të dhënash të përshtatshme për përpunim me sisteme kompjuterike. Pothuajse e gjithë krijimtaria njerëzore, shkencore, hulumtuese, shoqërore kulturore, e gjithë dituria e akumuluar gjatë shumë gjeneratave, po shërben si ushqim për IA-në. Kjo hap mundësi të jashtëzakonshme për njerëzimin, por edhe sfida të konsiderueshme dhe rrezikun që IA-ja, krahas diturisë, të trashëgojë edhe të gjitha të metat e shoqërisë, padrejtësitë, pabarazinë dhe diskriminimin.
16. Edhe pse IA-ja ka potencial të madh për të përmirësuar proceset dhe vendimmarrjen në shumë fusha, është e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm se në punën e saj vërehen gabime. Gjatë përdorimit të kësaj inteligjence duhet të jemi të vetëdijshëm për mundësinë e gabimeve dhe për shkaqet e mundshme të tyre dhe të ndërmarrim hapa për të minimizuar këto rreziqe përmes trajnimit të kujdesshëm, përditësimit të vazhdueshëm, testimit të plotë dhe monitorimit të vazhdueshëm të performancës së modeleve të Inteligjencës Artificiale.³

Veprimet e organizatave ndërkombëtare

17. Me qëllim që të sigurohet zhvillimi dhe përdorimi i IA-së në mënyrë të përgjegjshme, transparente dhe në përputhje me të drejtat ndërkombëtare dhe vlerat universale, organizatat ndërkombëtare ndërmorën iniciativa për rregullimin e përdorimit të saj përmes akteve normative dhe qëndrimeve me karakter rekomandues. Këto iniciativa synojnë vendosjen e standardeve për parandalimin e përdorimit abuziv të IA-së dhe shmangien e rreziqeve që lidhen me sistemet e saj, të cilat marrin vendime të rëndësishme pa mbikëqyrje njerëzore.

Aktet normative më të rëndësishme të nxjerra nga organizatat e Bashkimit Evropian dhe Këshilli i Evropës, si dhe disa iniciativa të dokumentuara me karakter këshilluese dhe rekomanduese

18. Bashkimi Evropian (në vijim: BE) në maj të vitit 2024 miratoi Rregulloren (BE) 2024/1689 që përcakton rregulla të harmonizuara për IA-në, që ndryshe njihet si Akti i BE-së për IA-në, i cili hyri në fuqi më 1 gusht 2024. Akti i BE-së për IA-në është korniza e parë ligjore gjithëpërfshirëse për IA-në në botë, që ka për qëllim të promovojë atë si të besueshme në Evropë dhe të sigurojë që sistemet e kësaj inteligjence të zhvillohen dhe përdoren në mënyrë të sigurt, transparente dhe në përputhje me të drejtat themelore të njeriut dhe vlerat e BE-së. Në thelb, BE-ja synon të balancojë inovacionin teknologjik me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurinë publike, duke e bërë IA-në të besueshme

³ Informatat mbi konceptin e Inteligjencës Artificiale dhe funksionimin janë ofruar nga ekspertja e fushës përkatëse e angazhuar nga IAP-ja.

dhe në shërbim të njeriut. Objektivat kryesore: (i) Të garantojë sigurinë dhe të drejtat themelore të individëve përballë përdorimit të teknologjive të IA-së; (ii) Të promovojë inovacionin e besueshëm dhe zhvillimin e sistemeve të IA-së që janë të pranueshme nga aspekti etik dhe ligjor; (iii) Të kategorizojë rreziqet që mund të paraqesë një sistem i IA-së dhe të vendosë detyrime të ndryshme për çdo kategori (rrezik i lartë, rrezik i ulët, ndalim etj.); (iv) Të rregullojë përdorimin e IA-së për sektorë kritikë, si: shërbimet publike, drejtësia, siguria, punësimi, arsimi, shëndetësia etj.; (v) Të mbrojë tregun e përbashkët të BE-së nga fragmentimi përmes rregullave të harmonizuara.⁴

19. Zyra Evropiane për IA-në dhe autoritetet e shteteve anëtare të BE-së janë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin Aktit të BE-së për IA-në. Sipas të dhënave të Komisionit Evropian, ky akt hyri në fuqi më 1 gusht 2024 dhe pritet të jetë plotësisht i zbatueshëm pas dy vjetësh (me disa përjashtime).

20. Komisioni Evropian në vitin 2019 publikoi Udhëzimet Etike për IA të Besueshme.⁵ Sipas këtyre udhëzimeve, IA-ja duhet të jetë: (i) Ligjore - duke respektuar të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi; (ii) Etike - duke respektuar parimet dhe vlerat etike; (iii) E qëndrueshme - si nga aspekti teknik, ashtu edhe duke marrë parasysh mjedisin social ku vepron. Udhëzimet paraqesin një grup prej 7 kërkesash kyçe që sistemet e IA-së duhet t'i përmbushin për t'u konsideruar të besueshme. Një listë specifike vlerësimi synon të ndihmojë në verifikimin e zbatimit të secilës prej këtyre kërkesave kryesore:

- i. Ndikimi njerëzor dhe mbikëqyrja: Sistemet e Inteligjencës Artificiale duhet të fuqizojnë njerëzit, duke u mundësuar atyre të marrin vendime të informuara dhe të mbrojnë të drejtat e tyre themelore. Gjithashtu, duhet të sigurohen mekanizma të përshtatshëm për mbikëqyrjen e këtyre sistemeve.
- ii. Qëndrueshmëria teknike dhe siguria: IA-ja duhet të jetë fleksibile dhe e sigurt, me plane për rimëkëmbje për rastet kur diçka shkon keq. Sistemet duhet të jenë të sakta, të besueshme dhe të riprodhueshme për të minimizuar dhe parandaluar dëmet.
- iii. Privatësia dhe qeverisja e të dhënave: Duhet të garantohen privatësia dhe mbrojtja e të dhënave, së bashku me mekanizma të duhur për qeverisjen e tyre, duke siguruar cilësinë, integritetin dhe qasjen e ligjshme në të dhëna.
- iv. Transparenca: Sistemet dhe modelet e IA-së duhet të jenë transparente. Mekanizmat e gjurmimit dhe shpjegimet e vendimeve duhet të jenë të qarta për palët e interesuara. Njerëzit duhet të jenë të vetëdijshëm kur ndërveprojnë me një sistem të IA-së dhe të informuar për aftësitë dhe kufizimet e saj.
- v. Diversiteti, mosdiskriminimi dhe drejtësia: Duhet të shmangët paragjykimin i padrejtë, pasi ai mund të ketë pasoja të shumta negative, nga marginalizimi i grupeve të cenueshme, te përkeqësimi i paragjyqimeve dhe diskriminimit. Duke nxitur diversitetin, sistemet e IA-së duhet të jenë të qasshme për të gjithë, pavarësisht nga ndonjë aftësi e kufizuar, dhe të përfshijnë palët e interesuara relevante gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor.

⁴ Komisioni Evropian, Akti i BE-së për IA-së: <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/regulatory-framework-ai>

⁵ Komisioni Evropian, Udhëzimet Etike për IA të Besueshme, 2019, <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/ethics-guidelines-trustworthy-ai>

- vi. Mirëqenia shoqërore dhe mjedisore: Nga IA-ja duhet të përfitojnë të gjitha qeniet njerëzore, përfshirë brezat e ardhshëm. Sistemet duhet të jenë të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, duke marrë parasysh ndikimet sociale dhe mjedisore.
- vii. Përgjegjshmëria: Duhet të vendosen mekanizma për të siguruar përgjegjësi dhe llogaridhënie për sistemet e IA-së dhe rezultatet e tyre. Auditimi dhe korrigjimi adekuat janë thelbësorë, veçanërisht në aplikimet kritike.⁶
21. Më 16 shkurt 2022, Këshilli i Evropës publikoi rezultatet e punës së Komitetit Ad-hoc të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale (CAHAI) mbi elementet e mundshme të një kornize ligjore për zhvillimin, dizajnin dhe zbatimin e inteligjencës artificiale, bazuar në standardet e Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Si rezultat, Komiteti CAHAI vërejti se zbatimi i sistemeve të Inteligjencës Artificiale ka potencialin të promovojë prosperitetin njerëzor dhe mirëqenien individuale dhe shoqërore përmes përparimit dhe inovacionit, por në të njëjtën kohë disa aplikime të sistemeve të kësaj inteligjence ngjallin shqetësim, pasi ato potencialisht paraqesin rreziqe për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Prandaj për të parandaluar dhe/ose zbutur këto rreziqe në mënyrë efektive, CAHAI konsideroi se një kornizë ligjore e përshtatshme për Inteligjencën Artificiale, bazuar në standardet e Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit, duhet të marrë formën e një instrumenti ligjorisht detyrues të përgjithshëm (transversal).⁷
22. Këshilli i Evropës, në vitin 2024, miratoi Konventën Kornizë për Inteligjencën Artificiale dhe të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Sundimin e Ligjit, e cila hyn në fushën e karakterit ligjorisht detyrues në këtë fushë. Më 5 shtator 2024, Konventa u hap për nënshkrime apo ratifikime nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Ajo synon të sigurojë që aktivitetet gjatë gjithë ciklit jetësor të sistemeve të IA-së të jenë plotësisht në përputhje me të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit, duke nxitur po ashtu përparimin teknologjik dhe inovacionin. Sipas kësaj Konvente, kërkohet që aktivitetet e sistemeve të IA-së duhet të përputhen me parimet themelore si vijon: Dinjiteti njerëzor dhe autonomia individuale; Barazia dhe mosdiskriminimi; Respekti për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale; Transparenca dhe mbikëqyrja; Përgjegjshmëria dhe llogaridhënia; Besueshmëria; Inovacioni i sigurt. Po ashtu, Konventa përfshin edhe masat për kompensim, të drejtat procedurale dhe masat mbrojtëse, si dhe kërkesat për menaxhimin e rrezikut dhe ndikimit.⁸
23. Komiteti për Inteligjencën Artificiale i Këshillit të Evropës (CAI), më 28 nëntor 2024, miratoi metodologjinë HUDEIRA (Metodologjia e vlerësimit të rrezikut dhe ndikimit të sistemeve të IA-së nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit). HUDEIRA është një udhëzues që ofron një qasje të strukturuar për vlerësimin e rrezikut dhe ndikimit të sistemeve të IA-së, që është i përshtatur veçanërisht për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Ky Udhëzues ka për qëllim të luajë një rol unik dhe të rëndësishëm në ndërthurjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe kuadrove teknike ekzistuese për menaxhimin e

⁶ Po aty.

⁷ Rezultatet e punës së Komitetit Ad-hoc të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale (CAHAI), 2022: <https://rm.coe.int/possible-elements-of-a-legal-framework-on-artificial-intelligence/1680a5ae6b>

⁸ Konventa Kornizë për Inteligjencën Artificiale dhe të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Sundimin e Ligjit <https://rm.coe.int/1680afae3c>

rezikut në kontekstin e IA-së. Metodologjia parashikon krijimin e një plani për zbutjen e rezikut, me qëllim minimizimin ose eliminimin e rreziqeve të identifikuara, duke mbrojtur publikun nga dëmet potenciale. Metodologjia kërkon rishikime të rregullta për të siguruar që sistemi i IA-së vazhdon të funksionojë në mënyrë të sigurt dhe etike, ndërsa ndryshon konteksti dhe teknologjia. Kjo qasje siguron që publiku të mbrohet nga rreziqet e reja gjatë gjithë ciklit jetësor të këtij sistemi inteligjent.⁹

24. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), në maj të vitit 2019, miratoi parimet e IA-së (të përditësuara më 2 mars 2020), të cilat janë udhëzime për zhvillimin dhe përdorimin e kësaj inteligjence, duke respektuar vlerat demokratike dhe të drejtat e njeriut. Këto parime janë ndër të parat të këtij lloji të përcaktuara në nivel të përfaqësuesve të qeverive. Parimet kryesore të miratuara nga kjo organizatë janë, por nuk kufizohen, si: i) IA-ja duhet të ofrojë përfitime për njerëzit dhe planetin duke nxitur rritje gjithëpërfshirëse, zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenie; ii) Sistemet e IA-së duhet të dizajnohen në një mënyrë që respektojnë sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, vlerat demokratike dhe diversitetin dhe duhet të përfshijnë masa të përshtatshme mbrojtëse, si: mundësinë e ndërhyrjes njerëzore kur është e nevojshme, për të siguruar një shoqëri të drejtë dhe të barabartë; iii) Duhet të ketë transparencë dhe zbulim të përgjegjshëm rreth sistemeve të IA-së për të siguruar që njerëzit të kuptojnë rezultatet e bazuara në këtë inteligjencë dhe të kenë mundësinë t'i sfidojnë ato; iv) Sistemet e IA-së duhet të funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme, të sigurt gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës, dhe rreziqet e mundshme duhet të vlerësohen dhe menaxhohen vazhdimisht; dhe v) Organizatat dhe individët që zhvillojnë, implementojnë ose operojnë me sistemet e IA-së duhet të mbahen përgjegjës për funksionimin e tyre të duhur në përputhje me parimet e mësipërme.¹⁰ Këto parime u përditësuan prapë në vitin 2024 në kontekst të zhvillimeve të reja të IA-së. Parimet e përditësuara adresojnë në mënyrë më të drejtpërdrejtë sfidat e lidhura me këtë lloj inteligjence, veçanërisht privatësinë, të drejtat e pronësisë intelektuale, sigurinë dhe integritetin e informacionit.¹¹

25. Në nëntor 2021, UNESCO miratoi një rekomandim për etikën e IA-së. Ky dokument është i rëndësishëm, sepse vendos një kuadër ndërkombëtar për zhvillimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të IA-së, duke përcaktuar parime dhe standarde etike: Sigurimin e respektimit të të drejtave të njeriut; Parandalimin e diskriminimit dhe abuzimeve të mundshme që mund të lindin nga përdorimi i IA-së; Promovimin e transparencës, besueshmërinë në teknologjitë e IA-së, duke rritur besimin e publikut; Sigurimin që IA-ja kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit; Vendosja e standardeve për llogaridhënie dhe përgjegjësi, duke siguruar që krijuesit dhe përdoruesit e IA-së të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre.¹²

Vlerësimi i ndikimit të Inteligjencës Artificiale në të drejtat themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës

⁹ Metodologjia HUDEIRA <https://rm.coe.int/cai-2024-16rev2-methodology-for-the-risk-and-impact-assessment-of-arti/1680b2a09f>

¹⁰ https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2019/06/what-are-the-oecd-principles-on-ai_f5a9a903/6ff2a1c4-en.pdf

¹¹ <https://www.oecd.org/digital/artificial-intelligence>

¹² <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000373434>

26. Në vijim, Avokati i Popullit do të ofrojë një analizë vlerësimi për mënyrën se si përdorimi i teknologjive të Inteligjencës Artificiale ndikon në respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky vlerësim synon të identifikojë sfidat, rreziqet dhe mundësitë që lidhen me përdorimin e IA-së në kontekstin kushtetues, duke pasur parasysh parimet e barazisë, dinjitetit, privatësisë, lirisë dhe të së drejtës për mbrojtje ligjore.
27. Analizimi i ndikimit të IA-së në të drejtat kushtetuese dhe identifikimi i rreziqeve potenciale dhe shkeljeve të mundshme u vlerësua duke u bazuar në vlerësimet e organizatave ndërkombëtare, si dhe rasteve praktike që u trajtuan në vende të ndryshme ndërkombëtare.
28. Në vazhdim Raporti do të trajtojë të drejtat e caktuara të njeriut, të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për të cilat, sipas standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, u parashikuan ndikime negative dhe rreziqe potenciale nga ndikimi i IA-së. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se sfidat e përshkruara këtu nuk janë të plota. Sistemet e IA-së mund të ndikojnë në të gjitha të drejtat e njeriut, për shkak të natyrës së tyre të pandashme dhe të ndërlydhura.

29. Neni 36 [E Drejta e Privatësisë]

“1. Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.

2. Kontrollat e cilësdo banesë ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratojë veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.

3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.

4. Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj.”

Rreziqet:

- i. E drejta për një jetë private kërcënohet nga ndjekja dhe mbikëqyrja e vazhdueshme që përdorin sistemet e IA-së për mbledhjen e të dhënave. Mungesa e transparencës mbi mënyrën se si funksionojnë këto sisteme krijon pasiguri për individët, të dhënat e të cilëve mund të zbulojnë jo vetëm interesat, por edhe cenueshmëritë e tyre. Rrjedhimisht, në këtë aspekt mund të krijohet çështja e pabarazisë, nëpërmjet posedimit

të të dhënave që zotërojnë kompanitë për përdoruesit, ndërsa përdoruesit mbeten të pasigurt për mënyrën si përdoren të dhënat e tyre nga kompanitë.¹³

- ii. Sistemet e IA-së mund të përdoren për të mbledhur dhe analizuar sasi të dhënash personale, duke përfshirë të dhënat biometrike, vendndodhjen dhe aktivitetet online, mirëpo duhet pasur parasysh që algoritmet e IA-së që përpunojnë të dhëna personale mund të jenë të ndjeshme për sa i përket sigurisë, për shkak të rrezikut të ekspozimit të informacionit personal të individëve dhe përdorimit të të dhënave personale jashtë qëllimit kryesor për të cilin janë mbledhur ato. Në rastet kur individët nuk informohen për mënyrën se si përdoren të dhënat e tyre nga sistemet e IA-së, të njëjtët nuk mund japin pëlqimin përkatës dhe rrjedhimisht u pamundësohet zotërimi i kontrollit mbi to.
- iii. Rrezik tjetër potencial mund të paraqesë përdorimi i teknologjive të mbikëqyrjes dhe monitorimit në hapësirat private të banimit, që mund të rezultojë me ndërhyrje në jetën familjare dhe private të individëve.

30. Neni 24 [Barazia para Ligjit]

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”

Rreziqet:

- i. E drejta për të mos u diskriminuar parashihet gjithnjë e më e rrezikuar, pasi sistemet e IA-së priren të përforcojnë pabarazitë sociale ekzistuese duke i shënjestëruar grupet e cenueshme. Sistemet teknologjike përkitazi me identifikimin nëpërmjet pamjes së fytyrës dhe modelimit të gjuhës treguan paragjykime ndaj pakicave racore dhe etnike, duke sjellë padrejtësi, të tilla si: arrestime apo akuza të pabazuara. Mungesa e transparencës dhe interesat që shërbejnë këto sisteme mund të rezultojnë në praktika manipulimi. Po ashtu, sistemet e IA-së shpesh përjashtojnë grupe të caktuara individësh me mungesë njohurish digjitale ose personat me aftësi të kufizuara.¹⁴
- ii. Rrezik tjetër potencial është diskriminimi nëpërmjet algoritmeve të IA-së. Algoritmet e IA-së mund të përforcojnë dhe riprodhojnë anshmëritë ekzistuese në të dhënat e trajtimit, duke rezultuar në diskriminim ndaj grupeve të caktuara me baza të mbrojtura. Shembull: nëse një sistem i IA-së përdoret në një institucion financiar në procesin e vlerësimit të aplikimeve për kredi, ai sistem trajnohet me të dhëna historike të kredidhënies. Rrjedhimisht, modeli i trajnuar me të dhëna që reflektojnë këtë fakt mund ta mësojë si rregull aprovimin e kredive duke zhvilluar vetë kritere për të aprovuar ose

¹³ ENNHRI, në ueb-faqen: <https://ennhri.org/ai-resource/key-human-rights-challenges/#::~:~:text=AI%2Ddriven%20on%20platforms,introduces%20new%20possibilities%20for%20abuse>

¹⁴ ENNHRI.

jo kredinë. I njëjti rrezik paraqitet nëse të dhënat janë të pabalancuara në karakteristika të tilla, si: gjinia, raca, kombësia, etnia etj. Prandaj sistemet e IA-së në këtë mënyrë rrezikojnë rritjen e pabarazive shoqërore.

- iii. Në rastet kur IA-ja përdoret për rekrutimin e punonjësve, në shërbimet publike dhe private, mund të rezultojë në marrjen e vendimeve të padrejta, që ndikojnë negativisht te grupet e marginalizuara.

31. Neni 40 [Liria e Shprehjes]

- “1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u enguar nga askush.*
- 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.”*

32. Neni 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike]

- “1. Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.*
- 2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”*

Rreziqet:

- i. Moderimi i përmbajtjes i udhëhequr nga IA-ja në platformat online mund të cenojë lirinë e shprehjes dhe mund të shkojë përtej asaj që kërkohet me ligj për gjuhën e urrejtjes apo përmbajtjen e paligjshme. Sistemet e IA-së kanë vështirësi në kuptimin e kontekstit dhe nuancës së të folurit, prandaj përdorimi i sistemeve digjitale hap rrugë të reja për abuzime. Gjithashtu, algoritmet që janë të dizajnuara në mënyrë manipuluese mund të ndikojnë në aftësinë për të bërë zgjedhje të lira dhe të pavarura. Në fund, kjo ndikon në pjesëmarrjen demokratike dhe rrjedhën e lirë të informacionit.¹⁵
- ii. Platformat e mediave sociale dhe të tjera mund të përdorin algoritme të IA-së për të monitoruar dhe censuruar përmbajtjet dhe në këtë mënyrë mundësojnë kufizimin e lirisë së shprehjes. Algoritmet mund të përdoren për të manipuluar informacionin dhe për të përhapur dezinformata, duke ndikuar negativisht në opinionin publik. Anshmëria dhe pasaktësia e algoritmeve të moderimit të përmbajtjes dhe mungesa e kuptimit të shprehjeve njerëzore, si metafora apo sarkazma, mund të ndikojë në përjashtimin e përmbajtjeve legjitime.
- iii. Në rastet kur IA-ja merr vendime të rëndësishme, përdoruesit duhet të kenë të drejtën të informohen, në mënyrë që ta kuptojnë plotësisht bazën e vendimeve dhe të kërkojnë ndryshime nëse janë të pasakta.

33. Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

- “1. E drejta e punës garantohet.*
- 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.”*

¹⁵ Po aty.

Rreziqet:

- i. Lidhur me të drejtën e punës dhe ushtrimin e profesionit, përdorimi i sistemeve të IA-së mund të ketë rrezik që individët me aftësi të kufizuara ose ata që nuk kanë aftësi digjitale mund të përjashtohen nga tregu i punës për shkak të automatizimit dhe përdorimit të teknologjive të avancuara.
- ii. Një rrezik tjetër potencial është vlerësuar përdorimi i algoritmeve të IA-së në procesin e rekrutimit të punonjësve. Përdorimi i IA-së për të lehtësuar dhe shpejtuar procesin e rekrutimit mund të ketë efekte negative duke prodhuar anshmëri në proces, që ndikon në mënyrë indirekte edhe në të drejta të tjera të njeriut.

34. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*

35. Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

- “1. Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*

Rreziqet:

- i. Sistemet e IA-së, përveçse përbëjnë kërcënime për transparencën dhe llogaridhënien, mund të cenojnë dhe të drejtën për mjet juridik efektiv. Kur teknologjia e sektorit privat përdoret edhe në hapësira publike, lindin pyetje për llogaridhënien dhe transparencën, për shkak të natyrës sekrete të algoritmeve. Publiku shpeshherë nuk ka qasje në proceset e vendimmarrjes dhe për këtë arsye e ka të vështirë të sfidojë rezultatet. Kjo pengon të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtën për një mjet juridik efektiv.¹⁶
- ii. Në rast të vendimmarrës automatike në sistemin e drejtësisë, përdorimi i IA-së mund ta rrezikojë vendimmarrjen e drejtë dhe të paanshme, në rast se algoritmet e përdorura janë të njëanshme ose të pasakta. Kur vendimet merren nga algoritmet, mund të jetë e vështirë për individët të kërkojnë përgjegjësi për vendime të padrejta.

36. Neni 35 [Liria e Lëvizjes]

[...]

- “5. E drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për t'u vendosur në vend, rregullohet me ligj.”*

Rreziqet:

- i. Përdorimi i sistemeve të IA-së në vendimmarrjen automatike për çështjet e imigracionit, përkatësisht në vendimmarrjen për azil ose të tjera, mund të rezultojë në vendime të pasakta ose të padrejta që ndikojnë negativisht në të drejtat e refugjatëve dhe të kërkuarëve të azilit.

¹⁶ Po aty.

37. Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

- “1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim: [...].*
- 2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, Brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.*
 - 3. Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet.*
 - 4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.*
 - 5. Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.*
 - 6. Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*

Rreziqet:

- i. Lidhur me të drejtën e lirisë dhe sigurisë, specifikisht të profilizimi dhe ndalimi, algoritmet e IA-së të përdorura për zbatimin e ligjeve përkatëse mund të rezultojnë në profilizim të padrejtë dhe ndalime të pabaza, për shkaqe të analizimit të të dhënave nga sistemi, të cilat janë të njëanshme ose të pasakta.
- ii. Përdorimi i teknologjive të mbikëqyrjes dhe identifikimit përmes portretit të fytyrës mund të ndikojë në ndjekje dhe kontroll të tepruar të individëve, duke rrezikuar lirinë dhe sigurinë e tyre personale.

38. Neni 47 [E Drejta për Arsimin]

- “1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike.*
- 2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.”*

Rreziqet:

- i. Përdorimi i IA-së në arsim mund të krijojë një hendek të thellë ndërmjet atyre që kanë qasje në teknologji të avancuar dhe atyre që nuk e kanë këtë mundësi, duke përkeqësuar pabarazinë arsimore.

- ii. Algoritmet e IA-së, nëse përdoren për vlerësimin e nxënësve, mund të jenë të njëanshme dhe të padrejta, që mund të ndikojnë negativisht në mundësitë arsimore të disa nxënësve.

39. Neni 51 [Mbrotja Shëndetësore dhe Sociale]

- “1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.*
- 2. Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.”*

Rreziqet:

- i. Përdorimi i gjerë i IA-së dhe automatizimi mund të ndikojnë në rritjen e pabarazisë ekonomike dhe përjashtimin e disa grupeve nga tregu i punës, që do të rrezikonin të drejtat sociale dhe ekonomike.

40. Neni 26 [E Drejta e Integritetit Personal]

“Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që përfshin:

- (1) të drejtën që të marrë vendime lidhur me reprodukimin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj;*
- (2) të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e saj/tij në pajtim me ligjin;*
- (3) të drejtën që të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj në pajtim me ligjin;*
- (4) të drejtën që të mos marrë pjesë në eksperimente mjekësore ose shkencore, pa pëlqimin paraprak të saj/tij.”*

Rreziqet:

- i. Përdorimi i IA-së në mjekësi mund të ndikojë në diagnoza dhe trajtime të njëanshme nëse të dhënat e përdorura për të trajnuar algoritmet janë të njëanshme ose jo të plota.

41. Neni 23 [Dinjteti i Njeriut]

“Dinjteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.”

Rreziqet:

- i. Dëmtime strukturore që prekin dinjitetin njerëzor. Përveç sfidave specifike për të drejtat e njeriut, IA-ja ndikon thellësisht në dëmtime strukturore që prekin dinjitetin e njeriut. Teknologjitë në cilësinë e mbikëqyrjes cenojnë autonominë, vetëqeverisjen dhe vetëvendosjen nga individët. Në të njëjtën kohë, teknologjitë për njohjen e emocioneve rrezikojnë të çnjerëzojnë individët duke i reduktuar ata në pika të dhënash, të shpëputura nga vlera dhe dinjteti i tyre i natyrshëm.¹⁷

Disa raste rreth ndikimit negativ të IA-së në të drejtat e njeriut

42. *Diskriminimi gjinor në algoritmet e programeve për rekrutim:* Në disa raste u vërejt se përdorimi i IA-së mund të shkaktojë diskriminim. Rasti i Amazon tregon përdorimin e IA-së në rekrutim dhe rreziqet e diskriminimit që mund të shkaktojë. Në 2014, Amazon

¹⁷ ENNHRI.

krijoi një sistem IA për përzgjedhjen automatike të kandidatëve bazuar në analizën e CV-ve të mëparshme. Sistemi diskriminonte gratë, pasi u trajnua me të dhëna që ndikonin në përjashtimin e grave si aplikuese, edhe pse nuk përdorte informacion direkt për gjininë. Për këtë arsye, në 2015 Amazon ndaloi përdorimin e tij duke theksuar rëndësinë e diversitetit dhe barazisë në punë. Kjo tregon se IA-ja bazon vendimet në të dhënat historike që reflektojnë paragjykimet njerëzore dhe pabarazitë ekzistuese. Edhe kur eliminohen të dhënat direkte për gjininë, sistemi gjen indikatorë të tjerë që tregojnë gjininë, si: vendi i studimit ose interesat. Kjo kërkon kujdes të vazhdueshëm etik në përdorimin e IA-së në rekrutim për të parandaluar diskriminimin dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, sidomos me rritjen e përdorimit të IA-së në intervista dhe përzgjedhje në procesin e rekrutimit të stafit.¹⁸

43. *Diskriminimi për shkak të ngjyrës:* Glenn Rodríguez u arrestua në moshën 16-vjeçare për përfshirjen e tij në një grabitje të armatosur ndaj një shitësi makinash, e cila rezultoi me vdekjen e një punonjësi. Në vitin 2016, 25 vjet më pas, ai aplikoi për lirim me kusht në Bordin e Lirimit të Institucionit Korrektues Lindor në veri të Nju Jorkut. Edhe pse Rodríguez pati një rekord të shkëlqyer rehabilitimi (Wexler 2017b), kërkesa e tij për lirim me kusht u refuzua, me arsyetimin e Bordit se një sistem inteligjence artificiale, i njohur si COMPAS, e kategorizoi atë si “me rrezik të lartë” dhe Bordin konkludoi se lirimi në mbikëqyrje nuk ishte në interes të mirëqenies së shoqërisë (Wexler 2017a). Bordin i Lirimit nuk pati qasje në mënyrën e saktë të kalkulimit të këtij rezultati, pasi kompania zhvilluese e algoritmit e mbajti atë si një sekret tregtar (ibid). Përmes krahasimit me rezultatet e të burgosurve të tjerë, Rodríguez arriti të kuptonte se arsyeja e vlerësimit të tij si “rrezik i lartë” bazohej në vlerësime subjektive të rojeve të burgut, të cilat mund të kenë qenë të ndikuara nga paragjykime racore. Edhe pse ai u lirua para kohe, po ta kishte mundësinë ta shqyrtonte dhe ta sfidonte logjikën e sistemit COMPAS, për të vërtetuar se rezultati i tij paraqiste një interpretim të shtrembëruar të situatës së tij personale, ai do të mund të lirohej shumë më herët.¹⁹

44. *Mbikëqyrja përmes të dhënave biometrike:* Mbikëqyrja përmes të dhënave biometrike përdor informacionin biometrik të individëve për të realizuar monitorimin dhe ndjekjen e tyre. Një shembull konkret është përdorimi i të dhënave biometrike të një personi të dyshuar për aktivitet kriminal, në mënyrë që të ndiqet dhe mbikëqyret ai në kohë reale. Teknologjitë e avancuara të inteligjencës artificiale i dhanë një dimension të ri mbikëqyrjes biometrike: derisa më parë mbikëqyrja përqendrohej në disa individë, sot sistemet moderne të video-vëzhgimit dhe algoritmet e njohjes së imazheve mundësojnë monitorimin e komuniteteve të tëra në shkallë të gjerë. Rasti i Nijeer Parks është një ilustrim i rrezikut i lidhur me përdorimin e teknologjisë së njohjes së fytyrës: ai u arrestua në mënyrë të padrejtë për një krim që nuk e kreu, për shkak të një gabimi në këtë sistem (Hill, 2020). Parks u akuzua gabimisht për vjedhje dhe përpjekje për të sulmuar një polic me makinën e tij, megjithëse në kohën e ngjarjes ai ndodhej 30 milje larg vendit të incidentit. Studimet tregojnë se teknologjia e njohjes së fytyrës ka performancë shumë më të mirë në identifikimin e burrave të bardhë, ndërsa rezulton të jetë shumë më pak e saktë për gratë me ngjyrë dhe, në disa raste, edhe për gratë e bardha (Balli, 2021). Kjo situatë

¹⁸ Bernd Carsten Stahl, Doris Schroeder, Rowena Rodrigues, Ethics of Artificial Intelligence, Case Studies and Options for Addressing Ethical Challenges, f.10.

¹⁹ Po aty, f. 12.

bëhet veçanërisht problematike kur forcat e rendit u besojnë më shumë rezultateve të teknologjisë sesa dëshmive apo fjalës së individëve të përfshirë.²⁰

45. *Përvetësimi i të dhënave*: Clearview AI, kompani softuerike me seli në Nju Jork, specializohet në teknologjinë e njohjes së fytyrës, veçanërisht në zbatimin e ligjit. Ajo mbledhi mbi dhjetë miliardë imazhe fytyrash dhe synon të arrijë 90 miliardë, duke përfshirë rreth 14 foto për çdo person në botë (Harwell, 2022). Në maj 2021, kundër Clearview AI u ngritën ankesa në disa vende evropiane, përfshirë Francën, Austrinë, Greqinë, Italinë dhe Mbretërinë e Bashkuar, pasi u zbulua se imazhet u mbledhën pa pëlqimin e përdoruesve nga platforma, si: Instagram, LinkedIn dhe YouTube (Campbell, 2021). Komisioni Francez për Mbrojtjen e të Dhënave (CNIL) urdhëroi kompaninë të ndalojë përpunimin dhe të fshijë të dhënat brenda dy muajsh (Bernd Carsten Stahl et al., 2021). Ky rast ilustron përvetësimin e paligjshëm të të dhënave personale, një praktikë që shkel GDPR-në dhe dëmton të drejtat individuale. Organizatat që operojnë në këtë mënyrë përfitojnë komercialisht pa ofruar kompensim të drejtë ndaj subjekteve të të dhënave.²¹

46. *Përdorimi i të dhënave personale shëndetësore*: Në vitin 2021, të dhënat personale të rreth 61 milionë individëve u ekspozuan për shkak të rrjedhjes së të dhënave nga një ofrues shërbimesh sigurimi shëndetësor në Nju Jork. Të dhënat përfshinin informacione të ndjeshme, si: emra, gjini, vendndodhje, datëlindje, peshë dhe gjatësi (Scroton, 2021). Studiuesi Jeremiah Fowler zbuloi bazën e të dhënave dhe raportoi kompaninë, e cila më pas siguroi mbrojtjen e tyre (Bernd Carsten Stahl et al., 2021). Ky incident evidenton rreziqet dhe dobësitë në mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave shëndetësore nga kompanitë që ofrojnë pajisje monitorimi shëndetësor, si dhe shqetësimet për përdorimin komercial të këtyre të dhënave.

Ndikimi pozitiv i Inteligjencës Artificiale në të drejtat e njeriut

47. Përderisa sfidat dhe rreziqet e përdorimit të Inteligjencës Artificiale janë objekt i gjerë shqyrtimi, është po aq e rëndësishme të evidentohen aspektet pozitive dhe mënyrat në të cilat kjo teknologji mund të kontribuojë në promovimin e dinjitetit, barazisë dhe lirisë së individit. Duke marrë parasysh se IA-ja është duke e transformuar mënyrën se si shoqëritë funksionojnë, është proklamuar se e njëjta ofron mundësi të jashtëzakonshme për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në shumë fusha, si: i) Përmirësimi i qasjes në drejtësi dhe transparencë; ii) Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë; iii) Konstatimi dhe parandalimi i diskriminimit; iv) Mbështetja për personat me nevoja të veçanta; v) Promovimi i lirisë së shprehjes dhe i së drejtës për informacion; vi) Ndihma në monitorimin e situatave të emergjencës dhe krimeve kundër njerëzimit; vii) Përmirësimi i kujdesit shëndetësor; viii) Rritja e produktivitetit dhe efikasitetit në biznes; ix) Avancimi arsimor; x) Përmirësimi i transportit; xii) Përmirësimi i sigurisë kibernetike; xii) Rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë në bujqësi; xiii) Zbulimi dhe përgjigjja ndaj katastrofave natyrore etj.

48. Nëse përdorimi i IA-së realizohet në mënyrë të përgjegjshme dhe etike, përfaqëson një mjet të fuqishëm për avancimin e të drejtave të njeriut, duke ofruar zgjidhje për sfidat komplekse sociale, ekonomike dhe ligjore, dhe të fuqizojë kategoritë më të cenueshme të

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty, f. 40.

shoqërisë. Megjithatë, kjo kërkon një angazhim të vazhdueshëm për zhvillimin e standardeve të forta etike, mekanizmave të mbikëqyrjes dhe politikave të përshtatshme që sigurojnë përdorimin e drejtë dhe transparent të këtyre teknologjive.

Analiza ligjore

49. Vlerësimet, konkluzionet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit lidhur me këtë raport bazohen në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet relevante të zbatueshme në vend, me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim: KEDNJ) dhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim: GjEDNJ).
50. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 7 [Vlerat], paragrafi 1, përcakton: “*Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.*” Respektivisht ky nen ka për qëllim të përcaktojë dhe mbrojë vlerat dhe parimet kryesore që garantojnë funksionimin demokratik, të drejtë dhe të qëndrueshëm të Republikës së Kosovës. Ky nen është themeli mbi të cilin ndërtohet i gjithë sistemi kushtetues dhe ligjor i vendit.
51. Po ashtu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] shprehimisht garanton si në vijim: “*1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. 2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. 3. Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. 4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.*” Përmes këtij neni, Kushtetuta vendos bazën kushtetuese për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave, duke theksuar rëndësinë e tyre për gjithë shoqërinë dhe institucionet e shtetit. Në thelb, ky nen ka për qëllim të sigurojë që të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të jenë themeli i funksionimit të shtetit dhe shoqërisë në Kosovë, duke garantuar që ato respektohen, mbrohen dhe zbatohen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.
52. Republika e Kosovës dëshmon vazhdimisht angazhimin e saj për të mbrojtur të drejtat themelore të njeriut në përputhje me standardet ndërkombëtare duke i dhënë prioritet në juridiksionin e vendit. Kushtetuta në nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] garanton zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare kryesore²² me fuqi të barabartë me Kushtetutën dhe duke u dhënë përparësi mbi ligjet dhe aktet e tjera të institucioneve publike në rast se ka ndonjë konflikt midis tyre.

²² (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese; (9) Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

53. Në kuadër të zbatimit të KEDNJ-së dhe Protokolleve të saj²³, shtetet janë të detyruara të krijojnë kushte që sigurojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky detyrim është evidentuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, i interpretuar si një “detyrim pozitiv” që shteti duhet ta realizojë për të siguruar mbrojtjen, respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut.
54. Qëllimi kryesor i instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është të formulojnë dhe garantojnë këto të drejta, ndërsa mbrojtja e tyre lidhet ngushtë me mekanizmat garantues dhe detyrimet e shteteve. Prandaj, organet ndërkombëtare të kontrollit i kushtojnë vëmendje të veçantë identifikimit dhe përkufizimit të këtyre detyrimeve, veçanërisht në fushën e të drejtave të njeriut, ku parimi i efektivitetit ka një rol kyç. Ky parim kërkon që angazhimet të interpretohen në atë mënyrë që të sigurojnë mbrojtje reale të individit dhe të adaptohen me zhvillimet shoqërore, duke i dhënë kështu jurisprudencës një karakter progresiv.
55. Prandaj, për të përcaktuar shtrirjen dhe rëndësinë e detyrimeve të shtetit, organet relevante duhet të ndjekin qasjet më të rëndësishme siç është vlerësimi i natyrës së detyrimeve që çdo e drejtë përmban, të cilat mund të kategorizohen në tri lloje kryesore: “*Detyrimi për të respektuar*” - që kërkon nga organet dhe ushtruesit e pushtetit publik të shmangin shkeljet; “*Detyrimi për të mbrojtur*” - që detyron shtetin të sigurojë mbrojtje ndaj cenimeve nga palë të treta dhe të sanksionojë autorët e shkeljeve; dhe “*Detyrimi për të zbatuar*” - që kërkon miratimin e masave pozitive dhe të përshtatshme për konkretizimin dhe efektivitetin e plotë të të drejtave të garantuara.
56. Bazuar në këtë qasje dhe me synimin për t’i adresuar sfidat specifike që lindin gjatë funksionimit të sistemeve të IA-së, si dhe për të marrë në konsideratë rreziqet dhe ndikimet më të gjera të kësaj teknologjie mbi të drejtat themelore të njeriut, si çështje prioriteti, është e nevojshme vendosja e një kuadri ligjor që përcakton parime dhe rregulla të përgjithshme, të cilat rregullojnë përdorimin e sistemeve të IA-së në mënyrë të përgjegjshme, pa i cenuar të drejtat e njeriut dhe duke ruajtur në mënyrë efektive vlerat e përbashkëta në shfrytëzim të përfitimeve të kësaj inteligjencës për të nxitur inovacionin përgjegjës.
57. Avokati i Popullit, duke u bazuar në informatat e ofruara nga Ministria e Ekonomisë nëpërmjet përgjigjes zyrtare, vlerëson veprimet e ndërmarra nga kjo e fundit në lidhje me nismën fillestare të integritetit të plotë të akteve ndërkombëtare në legjislacionin vendor lidhur me IA-në, përkatësisht, siç është theksuar, me hartimin e legjislacionit të ri, përshtatjen e ligjeve ekzistuese, si dhe pjesëmarrjen aktive në forume ndërkombëtare që adresojnë sfidat dhe mundësitë që paraqet AI-ja, përfshirë përcjelljen e zhvillimeve ndërkombëtare në këtë fushë që të veprohet në përputhje me masat e ndërmarra në vendet e tjera. Një ndër hapat pozitivë në këtë aspekt është miratimi i Agjendës Digjitale të Kosovës 2030 nga Qeveria e Kosovës, si një dokument strategjik me të cilin synohet zhvillimi i vendit drejt një shoqërie të zhvilluar digjitale; Strategjia e Kosovës për Teknologjinë Informativë; si dhe parashikimi i hartimit të Strategjisë së Kosovës për

²³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]: “*Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: [...] (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; [...].*”

58. Megjithatë, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen e autoriteteve kompetente që në rrafshin e zhvillimeve digjitale, respektimi i të drejtave të njeriut është thelbësor dhe kërkon një balancë të kujdesshme ndërmjet mundësive dhe rreziqeve, siç praktikohet me standardet ndërkombëtare. Duke marrë parasysh që aspekti i të drejtave të njeriut nuk është përfshirë në Agjendën Digjitale të Kosovës 2030, duke e vënë në pah rëndësinë e saj, është e nevojshme të theksohet se aspekti i të drejtave të njeriut duhet të jetë i integruar në dokumentet strategjike për zhvillimin e digjitalizimit dhe IA-së në vend.
59. Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës ndërmorën një sërë masash të rëndësishme për të krijuar një kuadër ligjor të fortë dhe gjithëpërfshirës, që synon përdorimin e sigurt dhe të drejtë të IA-së, të shtjelluara më lart në pikat 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24 dhe 25 të këtij raporti. Masat përkatëse ndërkombëtare u ndërmorën me qëllim të krijimit të kuadrit të qartë ligjor dhe gjithëpërfshirës, që siguron përdorimin e sigurt, të drejtë dhe të përgjegjshëm të teknologjive të IA-së dhe të sigurojë që përdorimi i sistemeve të kësaj inteligjence të jetë plotësisht në përputhje me të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Meqenëse shtetet anëtare të BE-së, sipas direktivave përkatëse specifike, janë në përgatitje e sipër drejt rregullimit, krijimit të mekanizmave të nevojshëm dhe vetëdijesimit për zbatimin e Aktit të BE-së për IA-në, këta hapa do të duhej të përcilleshin edhe nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës, në mënyrë që vendi të jetë në hap me shtet evropiane në fushën e IA-së.
60. Prandaj, duke u bazuar në zhvillimet ndërkombëtare lidhur me ndërmarrjen e masave të nevojshme për rregullimin ligjor të përdorimit të teknologjive të IA-së dhe duke u bazuar te fakti i zhvillimeve të shpejta në shkencë dhe teknologji, Avokati i Popullit e vlerëson të nevojshme ndërmarrjen e masave adekuata nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, për të parandaluar ndikimin negativ të teknologjive të IA-së në të drejtat e njeriut në vend. Avokati i Popullit vlerëson se masat njëherësh do të nxisinin besueshmërinë në sistemet e Inteligjencës Artificiale, e cila mund të ofrojë mundësi të pakrahasueshme për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit, duke u bazuar në të gjeturat e paraqitura në këtë Raport, konstaton si në vijim:

61. Avokati i Popullit, konstaton se zhvillimi dhe përdorimi i teknologjive të Inteligjencës Artificiale përveç se mund të kontribuojë në përmirësimin efikasitetit dhe qasjen në shërbime, megjithatë, në mungesë të garancive të duhura ligjore dhe etike, këto teknologji mund të paraqesin kërcënime të konsiderueshme për të drejtat themelore të njeriut. Avokati i Popullit konstaton se në sistemin juridik të vendit ende nuk ka dispozita normative që rregullojnë përdorimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e teknologjive të IA-së, përkatësisht nuk ekziston ende një bazë ligjore detyruese dhe mekanizma mbikëqyrës që garantojnë se sistemet e IA-së i respektojnë të drejtat themelore të njeriut gjatë funksionimit të tyre jetësor. Edhe pse Ministria e Ekonomisë përmendi disa përgjegjësi dhe iniciativa përkatëse, në mungesë të transparencës nuk u arrit të vlerësohej progresi i në këtë fushë.

62. Avokati i Popullit konstaton se në periudhën aktuale, në mungesë të rregullimit ligjor, asnjë institucion publik apo privat nuk është i detyruar t'i bëjë të ditur algoritmet që përdor, rrjedhimisht nuk ka asnjë mekanizëm ligjor mbikëqyrës dhe asnjë mekanizëm që garanton të drejtën për trajtim të vendimeve algoritmike. Kjo gjendje krijon mundësi për diskriminim i cili është vështirë të identifikueshëm, vendimmarrje të padrejtë dhe shkelje të së drejtës për mjet juridik efektiv. Përdorimi i IA-së në fusha si punësimi, arsimi, shëndetësia dhe siguria publike, nëse bazohet në të dhëna të njëanshme ose të papërfaqësuar, rrezikon të konsolidojë pabarazitë ekzistuese gjinore, etnike, sociale, ekonomike apo të aftësisë së kufizuar. Sistemet mund të jenë të ndërtuara dhe të trajnuara në atë mënyrë që nuk përfaqësojnë diversitetin shoqëror të vendit. Prandaj, autoritetet shtetërore përgjegjëse të Republikës së Kosovës, me prioritet duhet të ndërmarrin masa dhe veprime strategjike, ligjore dhe institucionale për të garantuar që përdorimi i IA-së të mos ketë ndikimin negativ në të drejtat themelore të njeriut në Republikën e Kosovës, por të zhvillohet dhe të përdoret në funksion të njeriut dhe të shoqërisë demokratike.
63. Avokati i Popullit konstaton se përdorimi i teknologjive të IA-së pa mbikëqyrje institucionale rrit mundësinë e cenimit të të drejtave themelore të njeriut dhe diskriminimit, të dhënave personale, përfshirë vendimmarrjen e padrejtë, shkeljen e privatësisë etj. Në mungesë të rregullimit ligjor dhe mekanizmave mbikëqyrës, sektori publik dhe privat mund të zhvillojnë dhe aplikojnë sisteme të IA-së në mënyrë të pakontrolluar në aspektin e të drejtave të njeriut. Rrjedhimisht, pa një trup të qartë rregullator, zhvillimi dhe përdorimi i IA-së mund të kalojë në duart e kompanive që nuk ofrojnë asnjë llogaridhënie publike. Po ashtu, nëse një sistem i IA-së trajnohet me të dhëna që reflektojnë stereotipa gjinorë ose etnik në vendimmarrje për punësim, sistemi do të përjetësojë diskriminimin në vend se ta eliminojë atë.
64. Andaj, Avokati i Popullit vlerëson se vendi duhet të krijojë bazë të mjaftueshme ligjore që rregullon fushën e IA-së, e cila duhet të harmonizohet me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, ose përmes një qasjeje parimore dhe gjithëpërfshirëse të ndërtohet një kornizë për IA-në, që mbështetet në sundimin e ligjit, transparencën dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për të garantuar siguri ligjore, mbrojtje efektive dhe respektim të plotë të të drejtave kushtetuese dhe standardeve ndërkombëtare.

Duke u bazuar në rrethanat e cekura më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “[...] *ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”; si dhe bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin administrativ të Kosovës, i

REKOMANDON

Kuvendit të Republikës së Kosovës:

- Përfshirjen e fushës së Inteligjencës Artificiale në kuadër të komisionit parlamentar, i cili e ka të integruar teknologjinë informative.
- Inicimin e procedurave për përfshirjen e Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale dhe të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Sundimin e Ligjit, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si instrument i zbatueshëm

drejtpërdrejt në kuadër të nenit 22.

Qeverisë së Republikës së Kosovës, Zyrës së Kryeministrit:

- Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për themelimin e një këshilli ndërinstitucional për Inteligjencë Artificiale, i cili koordinon hartimin e politikave dhe masave për përdorimin etik dhe të sigurt të IA-së.

Ministrisë së Digjitalizimit:

- Inicimin e rregullimit ligjor në vend për përdorimin etik të IA-së, përfshirë mekanizmat zbatues dhe mbikëqyrës, i bazuar apo i harmonizuar me Aktin e BE-së për IA-së dhe standarde të tjera të përshtatshme ndërkombëtare, në përputhje me të drejtat themelore të njeriut.

Agjencisë për Informim dhe Privatësi:

- Krijimi i një njësie të veçantë për auditimin e algoritmeve dhe sistemeve IA, për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe transparencën.

Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës:

- Integrimi në kurrikula dhe module mbi etikën e IA-së në arsimin e lartë dhe profesional, përfshirë fushat si drejtësia, shëndetësia, administrata publike dhe teknologjia.

Institutit të Kosovës për Administratë Publike:

- Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve për etikën dhe ndikimin e IA-së në të drejtat e njeriut, për të gjithë shërbyesit civilë.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit